
Analizë e Raportit Vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit

ANALIZË E POLITIKAVE

07/2020



Analizë e Raportit Vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit

Autor: **INDEP**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Qershor, 2020**

Foto e ballinës: **Pexels**

ISPN: **F3824284234**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondacionit të Vëllezërve Rockfeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje	4
Gjetjet kryesore të raportit.....	4
Mënyra e raportimit.....	5
Baza ligjore dhe institucionale	5
Aktivitetet për periudhën raportuese	7
Tarifat për Mitrovicën e Veriut	7
Prodhimi i uji, shitjet dhe uji pa faturuar	7
Investimet kapitale	8
Përfundime dhe Rekomandime	10
Pytjet pa përgjigje në raportin e ARRU-së.....	10

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), si pjesë e programit për Qeverisje Demokratike, dhe projektit për rritje të llogaridhënjes ka analizuar Raportin Vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) për vitin 2019. Analiza e INDEP është e fokusuar në identifikimin dhe vlerësimin e kualitetit të raportimit, të gjendjes së sektorit të ujërave në Kosovë si dhe në hartimin e rekomandimeve për Komisionin parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë, i cili bën licencimin dhe rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe të furnizimit të ujit të përpunuar dhe të papërpunuar me shumicë në Kosovë. ARRU është themeluar më 26 nëntor të vitit 2004 me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Ky institucion raporton në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit përfshin ndërmarrjet publike të licencuara të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizim të ujit me shumicë në Kosovë. Detyrat dhe funksionet e ARRU janë të përcaktuara në Ligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (Ligji Nr. 05/L-042). Ky institucion është përgjegjës për licencimin e shërbimeve, përcaktimin e tarifave, vendosjen e standardeve të shërbimeve, monitorimin e performancës së ofruesve, shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve, hartimin dhe miratimin e rregulloreve, inspektimin e standardeve dhe mbikqyrjen e zbatimit të akteve ligjore të Autoritetit.

Analiza e INDEP është organizuar në atë mënyrë që të pasqyrojë strukturën e raportit të ARRU. Pas Hyrjes dhe Përmbledhjes Ekzekutive, është analizuar çdo pjesë e raportit të ARRU-së. Ne kemi trajtuar kryesisht kualitetin e raportimit me qëllim që të informojmë deputetët mbi pjesët ku ka nevojë për informata shtesë apo sqarime shtesë. Në analizën tonë janë përshkruar edhe pyetje të cilat nuk kanë përgjigje brenda raportit dhe për të cilat ne kemi vlerësuar se duhen sqaruar më tutje. Kjo analizë është hartuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). Të gjeturat, qëndrimet dhe rekomandimet e këtij raporti nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e NED.

Gjetjet kryesore të raportit

Raporti i ARRU për vitin 2019 përmbanë 68 faqe, duke përfshirë këtu raportin vjetor, raportin vjetor financiar dhe një pjesë e cila emërohet si “Shpjegime për disa kategori të shpenzimeve”. Raporti paraqet aktivitetet e Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit (ARRU) të zhvilluara gjatë vitit 2019. Ky raport poashtu paraqet edhe zhvillimet kryesore në sektorin e ujit sa i përket gjendjes së nivelit të shërbimeve të cilat ofrohen nga ofruesit e licencuar të shërbimeve.

Të gjeturat kryesor të këtij raporti janë të paraqitura në pjesë të ndara të raportit. Këto të gjetura janë bazuar në krahasimi e raportit të vitit 2018 dhe raportin e fundit (2019). Kryesisht këto gjetje janë në pjesën e bazës ligjore dhe asaj institucionale ku lidhen me Ligjin e Pagave dhe ndryshimin

e Ligjit të prokurorit. Pastaj vazhdojnë me burimet njerëzore dhe pjesë e faturimeve dhe investimeve.

Përmes këtij raporti vërehen dallime të mëdha tek pagesat e shërbimeve të ujërve mes konsumatorëve të Mitrovicës së Veriut dhe konsumatorëve të pjesëve tjera të Kosovës. Këto dallime në çmime janë mjaft diskriminuese sa i përket pagesave ndaj këtyre konsumatorëve. Kjo çështje paraqet një problem mjaft të lartë i cili duhet të zgjidhet.

Në këtë analizë janë paraqitur edhe të gjetura të tjera të cilat janë të mangëta për nga sqarimi i hollësishëm i tyre. Duke filluar nga rritja e sasisë së ujit të humbur e duke vazhduar me sqarimet rreth investimeve kapitale të cilat janë mjaft konfuze. Këto pjesë raporti nuk i sqaron sa duhet.

Mangësi vërehen edhe tek planifikimet e veprimit për vitin 2020. ARRU nuk ka publikuar në këtë raport asnjë plan veprimi për vitin 2020. Përderisa ARRU është institucion me ndikim të madh në Kosovë, patjetër se deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe opinioni i gjerë duhet të informohen rreth planeve të veprimit të ARRU në vitin 2020.

Mënyra e raportimit

Raportimi vjetor i ARRU, është i ndarë në tri dokumente të ndryshme. Këto dokumente përmbajnë pjesë të ndryshme të raportit ku sqarojnë në vete disa detaje të raportit. Përderisa të trija janë në kuadër të raportit të ARRU, në mënyrë që qasja ndaj tyre të jetë më e lehtë për deputetët dhe opinionin e gjerë, shtrohet pyetja se përse këto pjesë nuk janë të përfshira në një dokument, qoftë në formë të anekseve ose në forma tjera.

Me theks të veçantë duhet përmendur se përpos raportit vjetor dhe atij financiar, si dokument i bashkëngjitur është edhe dokumenti i emëruar si “Spjegime për shpenzimet buxhetore për vitin 2019”. Në këtë pjesë sqarohen më gjerësisht shpenzimet për disa kategori. Përderisa këto kategori futen në kuadër të shpenzimeve të ARRU, përse duhet të publikohen si dokument i veçantë dhe përse nuk janë përfshirë në raportin vjetor në formë të aneksit. Sidhe gjatë raportimit, disa herë i referohet vegëzave të paraqitura për informata më të hollësishme rreth temave të caktuara.

Baza ligjore dhe institucionale

ARRU në raportin e këtij viti nuk e përmend Ligjin e Pagave në asnjë pjesë të raportimit. Ky institucion, sikurse institucionet e tjera publike në raportin e tyre vjetor duhet të sqarojnë ndikimin që ka Ligji i Pagave në to, sidhe të i paraqes më gjerësisht të dhënat lidhur me këtë çështje. Ky raport është i mangët sa i përket kësaj teme.

Në pjesën ku përshkruhen vështirësitë ligjore të ARRU, raporti përmend ndryshimin e Ligjit të prokurorit. Në raport thuhet se: “Ndryshimit të Ligjit të Prokurimit për institucionet e pavarura me më pak se 50 punëtorë, nuk i kryejnë procedurat e prokurimit në mënyrë vetanake por kryhen nga AQP, ka paraqitur shumë vështirësi për ARRU në ekzekutimin e buxhetit për vitin 2019 për shkak të të cilit kanë mbetur prokurimet të pa realizuara si kursi i gjuhës angleze”. Pa sqaruar mëtej se çfarë ka ndikuar mosrealizimi i këtij kursi, dhe se cilat prokurime tjera kanë mbetur pa u realizuar.

Sa i përket burimeve njerëzore, raporti nuk jep shumë detaje. Në këtë pjesë raporti thekson se gjatë vitit 2019 e kanë kompletuar stafin me plotësimin e një pozite të re sidhe kanë plotësuar një pozitë të zbrazët. Por detajet e hollësishme rreth këtyre dy pozitave, sidhe cilat pozita janë ato të cilat janë plotësuar dhe se a ka nevojë për shtimin e këtij numri.

Raporti në vijim thotë se:

Bazuar në të gjeturat gjatë inspektimit dhe të dhënat e dala nga Raporti, me qëllim të përmirësimit të nivelit të shërbimeve dhe mënyrës së mbajtjes së shënimeve nga ofruesit e shërbimeve, janë mbajtur tri punëtori për përfaqësuesit e ofruesit e shërbimeve me temat:

- Zhvillimi i burimeve njerëzore
- Zhvillimi i relacionit me konsumatorë
- Avancimi i sistemeve monitoruese në KRU – përdorimi i sistemeve SCADA

Pavarësisht të dhënave se janë mbajtur këto tri punëtori, raporti nuk sqaron më gjerësisht rreth këtyre punëtorive. Në këtë pjesë nuk ka të dhëna rreth numrit të përfaqësuesve që kanë marr pjesë në këto punëtori, sidhe sa kanë ndikuar këto punëtori në përmirësimin e nivelit të shërbimeve.

Sipas raportit, buxheti i planifikuar për ARRU për vitin 2019 ka qenë në vlerë prej 392370.63 €. Raporti më tej thekson se “buxheti final në fund të vitit ka qenë 358,169.87 €. Ky ndryshim ka ndodhur sipas kërkesës së Ministrit të Financave të aprovuar me vendimet e Kryeministrit Nr. 02/113 datë 05.11.2019 në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë prej 18,495.00 €, si dhe vendimi Nr. 03/115 i datës 17.12.2019 në kategorinë paga dhe medijtje në vlerë prej 15,705.76€”. Përderisa më poshtë thuhet se buxheti është shfrytëzuar 100%, athëherë përse askund në raport nuk spjegohen këto ndryshime rreth këtyre dy kategorive.

Në pjesën e rekomandimeve, ARRU e paraqet si rekomandim “MZHE si aksionar i ofruesve të shërbimeve të ujit të kontrollojë dhe ndalojë punesimet e paplanifikuara dhe të pa aprovuara nga organet kompetente me planet perkatese te biznesit, duke pasur parasysh se aktualisht numri I të punësuarëve tek ofruesit e shërbimeve është shumë i madh”. Ky problem nuk shtjellohet në asnjë pjesë të raportit. Andaj kjo çështje mjaftë me rëndësi duhet të sqarohet më gjerësisht në raportim, në mënyrë që të ndërmerren masa ndaj tij.

Në raportin financiar të tij, ARRU shkakton konfuzitet në mes të kategorive. Kjo më së shumti vërehet tek medijtjet. Medijtjet e udhëtimeve jashtë vendit janë të përfshira në kategorinë “Mallëra dhe shërbime”. Këto paraqiten si të veçuara prej medijtjeve brenda vendit të cilat përfshihen në kategorinë tjetër. Këto pjesë duhet të sqarohen më hollësisht se përse janë futur në kategori të ndryshme.

Aktivitetet për periudhën raportuese

Tarifat për Mitrovicën e Veriut

Faqe 17 dhe 19 të raportit, duhet me e sqaru pse dallojnë tarifat përmbledhëse vëllimore për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura të konsumatorëve në gjithë Kosovën dhe tarifat për Mitrovicën e Veriut dallojnë. Në raport thuhet se:

Tarifa për m³ për pjesën veriore është 0.17 €/ m³, tarifë kjo e llogaritur bazuar në Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR) ku janë të ndara kosto qendrat e shërbimeve të ujësjellësit. Sipas UKRR janë tre kosto qendra: (1) Resurset dhe Trajtimi i Ujit, (2) Distribuimi i ujit dhe (3) Aktivitetet Biznesore. Me anë të kësaj ndarjeje, krijohet mundësia për të pasur një pasqyrë më të qartë të alokimit të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes për të gjitha KRU-të në Kosovë (rasti: KRU “Mitrovica”). (Dard kete pjese nese kishe mujt me e shiku edhe ti)

Sa i përket komunat me popullatë serbe, raporti thekson:

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator të cilin aktualisht e zbaton ARRU.

Mirëpo nuk jep sqarime se përse këto ndërmarrje kanë mbetur jashtë procesit rregullator. Cilat kanë qenë arsyet se këto ndërmarrje kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit. Sidhe mungojnë sqarimet se çfarë ka ndodhur mëtej me këto ndërmarrje. A janë në pyetje problemet politike dhe si mendon ARRU që është rruga më e mirë për t'u zgjidhur këto probleme?

Sa i përket tarifave fikse, në raport thuhet se:

Tarifat fikse (€/muaj) për konsumatorët shtëpiakë për shërbimet publike të ujit, kanë mbetur të njëjta, që nga fillimi i përcaktimit të tyre (2005-2006), dhe do të ngarkohen për çdo muaj me nga 1.00 €/muaj, ndërsa konsumatorët jo-shtëpiak duke filluar nga viti 2018 janë ngarkuar me nga 2.00 €/muaj, për dallim prej 3.00€/muaj sa kanë paguar deri në fund të vitit 2017.

Pa jep sqarime të hollësishme rreth zvogëlimit të kësaj tarife. Nuk sqarohet se përse ka ardhur si rezultat i ndryshimit të shumës së kësaj tarife dhe se në bazë të çfarë vendimi ka ardhur deri tek ky ndryshim.

Prodhimi i ujit, shitjet dhe uji pa faturuar

Në tabelën 1, në faqe 17 të raportit janë të paraqitur vlerat e tarifave përmbledhëse vëllimore për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura për të dy grupimet e konsumatorëve 2016-2020. Këto vlera bazuar në këtë tabelë shihet se kanë pësuar një rritje të lehtë më një mesatare prej 0.1 cent. Ky ndryshim në këto vlera nuk sqarohet.

Tabela nr. 5 (sipas raportit) Të dhënat për ujin e prodhuar , të humbur, faturuar dhe numrin e konsumatorëve

Të dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Njësia matëse	Historiku i realizuar 2018	Aprovuar për vitin 2019	Realizuar për vitin 2019	% realizuar 2019
a	b	C	d	e	f= (e/d)
Uji i prodhuar	m ³	157,761,608	139,663,111	152,877,087	109%
Uji i humbur	m ³	91,526,261	68,360,040	84,813,113	124%
Uji i faturuar	m ³	66,235,347	71,303,072	68,063,974	95%
Konsumatorët	m ³	355,030	342,170	376,614	110%

Në raport janë të paraqitura në formë tabelare të dhënat rreth sasisë së ujit të prodhuar, humbur dhe faturuar. Raporti përmend se në bazë të këtyre vlerave konstatojnë se sasia e ujit të humbur dhe ajo e faturuar nuk janë realizuar dhe se performanca e tyre vlerësohet negativisht. Mirëpo, arsya se përse ka ndodhur ky vlerësim negativ dhe çfarë ka ndikuar në këtë performancë sa i përket ujit të humbur dhe atij të faturuar nuk është e sqaruar në këtë raport.

Investimet kapitale

Raporti përmend edhe pjesën e investimeve kapitale. Në këtë pjesë përmes tabelës paraqiten të dhënat rreth investimeve vetanake dhe investimeve nga donatorët. Pjesa ku duhet të sqarohet se a ka pasur investime kapitale dhe se a janë përmbushur caqet sa i përket investimeve kapitale mungon në këtë raport. Kjo pjesë përmendet vetëm në kuadër të raportit financiar ku shkruhet se nuk ka pasur investime kapitale.

Në raportin vjetor ARRU, në pjesën e investimeve kapitale në formë tabelare paraqen të dhënat sektoriale për investimet kapitale. Në këtë tabelë paraqiten investimet vetanake dhe investimet nga donatorët ku së bashku këto investime kapin vlerën rreth 2.5 mil€. Në raport thuhet se:

Për vitin 2019 investimet e përgjithshme kapitale në nivel të sektorit janë 2.5.mil. €. Nga kjo shumë 75% janë mjetet vetanake të KRU. Nga këto mjete 2.4 mil. €, janë investuar në shërbimin e ujësjellësit dhe pjesa prej 35 mijë €, në shërbimin e ujërave të ndotura.

Aktualisht janë në zhvillim e sipër edhe disa investime të rëndësishme në ngritjen e infrastrukturës dhe Impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në Regjionet: Prizren, Gjakovë dhe Pejë.

Mirëpo në këtë pjesë mungojnë të dhënat rreth këtyre investimeve, çfarë investime janë bërë, saktësisht në cilat vende, sidhe të dhënat rreth shumave që janë shpenzuar për këto investime kapitale. Gjithashtu në raportin vjetor financiar, në faqe 3 në pjesën e investimeve kapitale, shkruhet se ska pasur investime. Kjo pjesë duhet të sqarohet pasi që këto dy raporte e kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Në raport thuhet se uji i pafaturuar mbetet ende sfidë për ARRU. Në bazë të këtij raporti, uji i pafaturuar që ndryshe njihet edhe si “ujë i humbur”, në vitin 2018 rreth 58% e ujit të prodhuar është regjistruar si ujë i pafaturuar. Përderisa në raport përmendet se janë bërë investime rreth

shërbimit të ujësjellësit dhe shërbimit të ujërave të ndotur, përse kjo vlerë mbetet ende e madhe. Sidhe cilat janë masat që duhet marrë që të zvogëlohet sasia e këtij uji dhe përse këto masa nuk janë ndërmarrë më herët.

Problemet me faturimin paushall janë duke vazhduar ende. ARRU në Raportin Vjetor të vitit 2019 ka thënë se KRU Mitrovica dhe KRU Prishtina nuk kanë eliminuar ende faturimin paushall ndërkohë që në vitin 2018 kishte raportuar se KRU Prishtina ka rregulluar problemin e faturimit paushall.

Raporti i ARRU-së për vitin 2018	Raporti i ARRU-së për vitin 2019
KRU “Prishtina” ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të ARRU në Komisioni Shqyrtues, ankesë e cila është refuzuar nga ky Komision në mungesë të fakteve, prandaj KRU ka paguar gjobën prej 5000 euro. Pas përmbushjes së afatit të dhënë prej 45 ditë pune është zhvilluar inspektimi verifikues gjatë të cilit është gjetur se KRU “Prishtina” e ka rregulluar faturimin e kësaj kategorie të konsumatorëve në pajtim me nenin 37 të Rregullores Nr.02/2016	Si rezultat i hapave të ndërmarrë nga ARRU, nga gjithsej 13728 konsumatorë të faturuar pa matje (te gjetur ne Qershor 2019), në dhjetor të vitit 2019 kanë mbetur gjithsej 7533 konsumatorë të cilët faturohen pa matje – shprehur në përqindje ka pasur përmirësim për 54%. Vlen të theksohet se kanë mbetur edhe dy ofrues të shërbimeve (KRU “Prishtina” e cila ka afat deri në Mars 2020 dhe KRU “Mitrovica” e cila ka afat deri në Maj 2020 për të eliminuar faturimin pa matje, përderisa KRU-të tjera e kanë eliminuar në përgjithësi, apo u ka mbetur një numër i vogël i konsumatorëve (kryesisht rastet e konsumatorëve tek të cilët nuk kanë pasur qasje - të cilët nuk jetojnë në Kosovë).

Në raport janë të paraqitura në formë tabelare edhe shitjet e ujit në vlera sasiore për KRU “Mitrovica” dhe KRU “Prishtina”. Në bazë të këtyre të dhënave shihet se këto shitje janë ngritur nivelin prej 4.4 mil. m³ ose 10% në raport me vitin 2018. Raporti jep të dhëna edhe rreth shpenzimeve për funizimin e ujit me shumicë në nivelin prej 6%. Sqarimet rreth mënyrave se si ka ardhur deri në ngritjen e këtij niveli, sidhe çfarë kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve për funizimin e ujit më shumë, në këtë raport nuk sqarohen.

Trendi i kategorive të pandara siç janë paga dhe mëditje vazhdon edhe në këtë raport. Edhe pse këto dy kategori janë të ndryshme, përfshihen si të bashkuara. Në raportin financiar, kategoria mëditje është e paraqitur edhe tek fusha “paga dhe mëditje” sidhe në pjesën “mallëra dhe shërbime”. Andaj raporti duhet të sqarojë se çfarë përfshihet në këto dy fusha dhe se përse janë ndarë si kategori në vete, edhe pse në të dyja përmenden mëditjet, sidhe shumat për kategoritë si të ndara.

Në raportin financiar, në kategorinë paga dhe mëditje përmendet se janë shpenzuar 100%e mjeteve të dedikuara për këtë kategori. Në pjesën e dytë të tij shkruan se “rreth 15750 euro janë kthyer në Buxhetin e Kosovës nga kategoria Paga dhe Mëditje që kanë qenë të lira për arsye të mosplotësimit të pozitave të punës”. Kjo pjesë bie në kundërshtim në pjesën e dytë të raportit, dhe nuk jep kurrfarë sqarimi rreth këtyre pozitave se përse kanë mbetur të paplotësuara sidhe sa ka ndikuar në performancën e ARRU këto mungesa.

Përfundime dhe Rekomandime

Mënyra e raportimit duhet të jetë më e qartë. Që të jetë më e lehtë qasja ndar raportit dhe dokumenteve përcjellëse, raporti i ardhshëm është mirë që të jetë i përfshirë përmes një dokumenti në të cilin ndodhen të përfshira të gjitha të dhënat rreth atij raporti. Kjo do të ndihmonte që qasja e deputetëve dhe e opinionit të gjerë për raportin të jetë më e lehtë dhe më e kuptueshme.

Raporti duhet të spjegon ndikimin e Ligjit të pagave dhe ndikimin e ndryshimit të Ligjit të Prokurorit. Raporti nuk jep sqarime rreth Ligjit të Pagave për këtë institucion, nuk jepas një koment në lidhje me këtë ligj. E njëjta frymë vazhdon edhe te ndryshimi i Ligjit të Prokurorit, ku të dhënat janë të paakëta.

Pjesa rreth trajnimit të stafit dhe mbajtje s së punëtorive mund të themi se është gati plotësisht e pasqaruar. Raporti duhet të jepë më shumë të dhëna rreth kësaj çështje. Nuk dihet numri i punëtorëve të cilët kanë marrë pjesë në punëtori dhe se çfarë roli kanë pasur këto punëtori në rritjen e performancës të punëtorët.

Një sqarim më i hollësishëm duhet të kërkohet edhe tek pjesa e buxhetit. Ka mjaftë konfuzione sa i përket kësaj pjese. Ky konfuzion vazhdon edhe në ngatrrimet e kategorive. Kjo dallohet mjaftë tek pjesa e pagave dhe meditje. Pagesat e pagave dhe meditjeve janë të përshkruara në dy kategori komplet të ndryshme, sqarimet rreth këtyre mungojnë.

Raporti duhet të sqarojë investimet të cilat janë bërë në ujësjellës dhe sistemin e ujërave të ndotura. Këto investime a kanë ndikuar në rritjen e cillësisë së shpërndarjes së ujit dhe në rritjen e mbulueshmërisë së sistemit të ujërave të ndotura. Dhe duke pasur parasysh se këtë vit është rritur sasia e ujit të humbur, çfarë ka ndikuar në këtë rritje negative.

Edhe tek faturimi paushall ka mungesa në sqarime. Në raportin e vitit 2018 thuhet se KRU “Prishtina” i ka rregulluar faturimet paushall. Pas gjobës së vendosur, mirëpo në raportin e sivjetmë, veçohet përsëri se KRU “Prishtina” dhe KRU “Mitrovica” ende nuk i kanë përfunduar obligimet e tyre. Sqarimet rreth këtyre çështjeve mjaftë të ndjeshme duhet të merren me më shumë seriozitet.

Pytjet pa përgjigje në raportin e ARRU-së

- Përse nuk ka asnjë sqarim në raport lidhje me ndikimin potencial të Ligjit të Pagave në ARRU?
- Çfarë ka ndikuar në performancën e ARRU mosmbajtja e kursit të gjuhes angleze, si rezultat i ndryshimit te Ligjit të Prokurorit?
- Sa i përket burimeve njerëzore: Cilat pozita janë plotësuar dhe a ka nevojë për shtimin e numrit të punëtorëve?
- Sa kanë ndikuar në përmirësismin e shërbimeve punëtorite ë mbajtura, sa ka qenë numri i pjesëmarrësve dhe sa ka qenë buxheti i këtyre punëtorive?
- Rreth buxhetit të planifikuar dhe të shpenzuar: Përse askund nuk janë të sqaruara ndryshimet e buxhetit të cilat janë bërë në kategoritë “Paga dhe meditje” përderisa në raport thuhet se buxheti është shfrytëzuar 100%?

- Çfarë masa janë ndërmarrë që të ndalohet punësimi i paplanifikuar dhe i paaprovuar?
- Përse duhet të ndryshojnë tarifat e pagesave mes konsumatorëve të Mitrovicës së Veriut dhe pjesëve tjera të Kosovës?
- Përse komunat me shumicë serbe janë mbetur proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator të cilin aktualisht e zbaton ARRU dhe çfarë mendon ARRU se duhet bërë që kjo pjesë të futet
- Përse ka ardhur deri tek zvogëlimi i tarifave fikse për konsumatorët jo-shtëpiak. kurse për konsumatorët shtëpiakë nuk është bërë ndodnjë ndryshim?
- Rreth shitjes së ujit në vlera sasiore për KRU “Mitrovica” dhe KRU “Prishtina”: Cilat janë mënyrat se si ka ardhur deri në ngritjen e këtij niveli, sidhe çfarë kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve për furnizimin e ujit më shumë?
- Përse mëditjet për udhëtimet jashtë vendit janë të përfshira në kategorinë “Mallëra dhe shërbime”?